

Anketim mbi kushtet e jetesës dhe të drejtat e studentëve në Rezidencën Studentore Universitare Nr.1

Në kuadër të monitorimit të kushteve dhe shërbimeve ndaj studentëve por edhe faktimit të investimeve në konviktet e Rezidencës Studentore Universitare nr.1 në Tiranë, ekipi i Qëndresës Qytetare realizoi një pyetësor me 200 studentë për të kombinuar burimet e informacionit duke rritur përfshirjen dhe besueshmërinë publike ndaj rezultateve të studimit.

Fokusi i pyetësorit u shtri në disa linja kryesore që kishin të bënin kryesisht me:

- Infrastrukturën dhe hapësirat e akomodimit
- Kushtet higjieno-sanitare dhe sigurinë shëndetësore
- Të drejtën për ushqim dhe siguri
- Shërbimet e ofruara nga Drejtoria e RSU Nr. 1
- Pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje

Metodologjia e realizimit të pyetësorit

Gjetjet e anketimit të realizuar gjatë muajit shkurt 2020 me studentët që banojnë në godinat e Qytetit Studenti. Një ekip

prej 6 anketuesish iu drejtua 23 godinave të targetuara dhe realizoi plotësimin e **200 pyetësorëve** duke pyetur mesatarisht rreth 8 studentë për secilën godinë. Ekipi i anketuesve u shoqërua nga koordinatori i projektit dhe i gjithë procesi i anketimit u mbikqyr hap pas hapi nga stafi i Qëndresës Qytetare.

Para nisjes së punës në terren, anketimi u parapri nga hartimi i pyetësorit, konsultimi i pyetësorit me ekspertë të metodologjisë së kërkimit sasior dhe cilësor dhe rekrutimin dhe udhëzimin e anketuesve të terrenit.

2.1.1 Hartimi dhe testimi i pyetësorit

Pyetësori dhe njëkohësisht instrumenti kryesor i përdorur për mbledhjen e të dhënave u hartua nga stafi i Qëndresës Qytetare në bashkëpunim me studentë që banojnë në Qytetin Studenti, duke u bazuar në studime të mëparshme të ngjashme të realizuara nga organizata dhe nën mbikqyrjen e ekspertit të metodologjisë.

Testimi i pyetësorit u realizua para nisjes zyrtare të anketimit pranë godinave të targetuara. Kjo ishte një fazë mjaft e rëndësishme pasi siguroi ekipin e projektit që pyetjet ishin të qarta e të kuptueshme si për anketuesit ashtu edhe për të anketuarit. Zgjidhja e problematikave minimale të dala në këtë fazë garanoi efektivitetin e instrumentit dhe konsolidimin përfundimtar të tij.

2.1.2 Metodologjia e kampionimit

Para përcaktimit të kampionit, stafi implemetues i projektit bëri një përlllogaritje të numrit të studentëve që banojnë në godinat e Qytetit Studenti gjithashtu edhe numrin e tyre në secilën godinë të targetuar. Stafi vendosi të marrë një numër të konsiderueshëm kampioni prej rreth 8 studentësh për secilën godinë, dhe në total 200 studentë.

Për të garantuar nivelin e besimit 95% me tolerancë gabimi jo më shumë se $\pm 3\%$, kampioni i përzgjedhur në total në Qytetin Studenti ishte 200 studentë, ose shprehur ndryshe 4% e popullatës. Niveli i besimit tek metodologjia e zbatuar për të mbledhur informacion për kushtet e jetesës dhe perceptimin e studentëve mbi investimet në infrastrukturën e godinave në fund të pyetësorit të projektit kërkimor ishte 95%, i cili është një nivel shumë i lartë besueshmërie. Statisticienët pranojnë një nivel prej 95% të besimit si një standart i pranueshëm,

prandaj gjetjet e studimit janë të një niveli të lartë besueshmërie. Toleranca e gabimit për të gjithë studimin në konvikte është $\pm 3\%$.

Kampioni është përzgjedhur në mënyrë rastësore por duke u përpjekur të garantohet përfshirja e studentëve që ndiqnin dy nivelet e studimit. 64 % e studentëve të anketuar kanë qenë vajza dhe 36% e tyre kanë qenë djem.

Për të kuptuar problematikat e shfaqura ndër vite, studentët e intervistuar nga ekipi i anketuesve kishin eksperiencë kohore akomodimi të ndryshme. Pjesa më e madhe, rreth 42% e tyre e kishin vitin e parë të banimit. Në tabelën e mëposhtme renditen studentët e intervistuar sipas viteve të banimit në konvikte:



2.2 Gjetjet Kryesore

- **82.9%** e studenteve banore te **Qyteti Studenti** deshmojne se investimet ne konvikte nuk kane sjelle asnje permiresim apo nderhyrjet jane vetem ne fasade, **16.6** kane permiresuar disi kushtet dhe **0.5** kane pranuar permiresim te madh
- **70.5%** e studentëve u shprehën se banojnë **3** persona në një dhomë konvikti, **21.2 %** e tyre pohojnë se ndajnë dy persona një dhomë dhe **8.3%** e studentëve banonin më shumë se **3** persona në një dhomë. Ndërkohë **66.3%** e studentëve i konsiderojnë dhomat e konvikteve të vogla dhe të pamjaftueshme për të jetuar, ndërsa për **33.7%** të studentëve këto dhoma janë mëse normale.
- **79.9%** e studentëve e konsiderojnë higjienën dhe kushtet e tualeteve te keqai dhe shumë të këqija, ndërsa **7.1%** e tyre i vlerësojnë të mira apo shumë të mira këto kushte. Ndërkohë **99%** e studentëve shprehen se në tualetet e **Qytetit Studenti** mungojnë, sapunët dhe letrat higjienike, materiale të cilat sata i blejnë me paratë tyre.
- Rreth **80.3%** e studentëve mendojnë se **Qyteti Studenti** duhet të ofrojë vetë shërbimin e mensave publike, **15%** e studentëve nuk janë të interesuar ndërsa **4.7%** e tyre mendojnë se kjo nuk duhet të ndodhë. Ndërkohë rreth **50.8%** e studentëve i konsiderojnë çmimet në mensat private si të papërballueshme për ekonominë e tyre.
- **97.5%** e studentëve u shprehën se ngrohjen në dhomën e tyre e sigurojnë nëpërmjet pajisjeve të sjella privatisht në konvikt, Ndërkohë **78.8%** e tyre mohojnë praninë e sinjalistikës apo pajisjeve kundër zjarrit në ambientet e konviktëve.
- **8.5%** e studentëve shprehen se nuk janë pyetur asnjëherë lidhur më cilësinë e shërbimeve të **Qytetit Studenti**, **10.9%** shprehen se janë pyetur por opinionet e tyre nuk janë marrë parasysh, ndërsa vetëm **3.6%** pohojnë se sugjerimet e tyre janë marrë parasysh nga vendimmarrësit në **RSU nr.1**.

Analiza e detajuar e të dhënave të pyetësorit

2.3.1 Infrastruktura dhe hapësirat e akomodimit

Për të kuptuar më mirë gjendjen e hapësirës ku studentët kalojnë pjesën më të madhe të ditës, pra dhomën e tyre të përbashkët, ata u pyetën mbi numrin e personave që banojnë në një dhomë dhe opinionin e tyre mbi këtë hapësirë.


70.5% e studentëve u shprehën se banojnë 3 persona në një dhomë konvikti, 21.2% e tyre pohojnë se ndajnë dy persona një dhomë, ndërsa 8.3% e studentëve banojnë më shumë se 3 persona në një dhomë konvikti.

Shumica e studentëve të pyetur, 66.3% i konsiderojnë dhomat e konvikteve në Qytetin Studenti të vogla dhe të pamjaftueshme për të jetuar, ndërsa për 33.7% të studentëve këto dhoma janë mëse normale.


Studentët i vlerësuan pajisjet dhe moblijet e ofruara nga numri 1 që përfaqëson "shumë keq" tek numri 5 "shumë mirë". Vihet re një pakënaqësi e lartë në vlerësimin ndaj këtyre pajisjeve ku më shumë se gjysma e studentëve 51.8% i vlerësojnë me notën 1, pra shumë keq.

Kjo pakënaqësi vërehet në disa drejtime, por për ta konkretizuar ekipi i Qëndresës i pyeti studentët mbi praninë e hapësirës apo raftit për të vendosur libra në dhomën e tyre, element që lidhet edhe me procesin e studimit. 50.8% e studentëve u shprehën se kanë hapësirë/raft për të vendosur librat por është e pamjaftueshme, 36.8% e tyre pohuan se nuk ka një hapësirë për të vendosur librat në dhomën e tyre ndërsa 12.4% e studentëve të pyetur shprehën se hapësira që kanë në dhomën e tyre u mjafton për të vendosur librat.


Sa persona banojnë në dhomë?




Si i konsideroni hapësirat brenda dhomës në konvikti?



Si i vlerësoni Mobiljet dhe Pajisjet e ofruara nga konvikti:



Keni hapësira për të vendosur libra në dhomë?



2.3.2 Kushtet higjiene –

sanitare dhe siguria shëndetësore


Nisur nga ankesat e shumta dhe anketa e realizuar nga Qendresa Qytetare në vitin 2017 mbi këtë çështje, studentët u pyetën për disa tregues bazë që lidhen me higjienën në ambientin dhe jetesën në konvikte.¹

82.9% e studentëve e konsiderojnë higjienën dhe kushtet e tualeteve shumë të këqija, ndërsa 17.1% e tyre i vlerësojnë të mira dhe shumë të mira këto kushte. 99% e studentëve shprehën se në tualetet e Qytetit Studenti mungojnë, sapunët dhe letrat higjienike, materiale të cilat studentët pohojnë se i blejnë me paratë tyre, ndërsa vetëm 1% e studentëve janë shprehur se këto materiale i siguron drejtoria e konviktit.


Nisur nga fakti i orarit të kufizimit të dusheve gjatë pasditeve, 41% e studentëve u shprehën se këto orare janë të papërshtatshme dhe kthehen në pengesë për studentët që studiojnë ose punojnë pasdite. Ndërkohë 59% e studentëve të pyetur pohojnë se oraret e dusheve janë normale dhe të përshtatshme për ta.

Të pyetur mbi orarin e ujit, 84.5% e studentëve u shprehën se kanë 24 orë ujë të pijshëm në dhomën e tyre, 7.3% pohuan se kanë ujë në dhomën e tyre vetëm gjysëm dite dhe 6.2% vetëm 2 deri në 6 orë.


Si i vlerësoni kushtet dhe higjienën e tualeteve?




Oraret e dusheve për ju janë?



A sigurohen letra higjienike dhe sapunë në tualetet nga konvikti?



Sa orë në ditë keni ujë në dhomë?



¹ <http://qq.com.al/index.php/2018/02/02/analize-e-kushteve-higjiene-sanitare-ne-konviktet-e-qytetit-studenti/>

2.3.3 E drejta për ushqim dhe siguri

Ndryshe nga shoqëritë e akomodimit studentor në Rajon dhe Europë, në Qytetin Studenti nuk ofrohet shërbimi i mensës publike për studentët e akomoduar. Prandaj në rezultatet e pyetësorit, 21.2% e studentëve frekuentojnë mensat private dhe ushqimin e shpejtë pranë Q.S, 33.7% e tyre pohuan se gatuajnë në dhomë, ndërsa pjesa më e madhe, 45.1% e tyre u shprehën se përdorin të dyja alternativave e sipërpërmendura.

80.3% e studentëve mendojnë se Qyteti Studenti duhet të ofrojë vetë shërbimin e mensave publike, 15% e studentëve nuk janë të interesuar ndërsa 4.7% e tyre mendojnë se kjo nuk duhet të ndodhë.

50.8% e studentëve i konsiderojnë çmimet në mensat private si të papërbalueshme për ekonominë e tyre personale, ndërsa 49.2% i konsiderojnë ato të përbalueshme.

Studentët u pyetën mbi funksionimin e infrastrukturës së ngrohjes në konvikte. 97.5% e studentëve u shprehën se ngrohjen në dhomën e tyre e sigurojnë nëpërmjet pajisjeve të sjella privatisht në konvikt, ndërsa vetëm 2.6% e tyre u shprehën se ngrohja sigurohet nëpërmjet sistemit të konvikteve.

Si e siguroni ushqimin ditor?



21.2% Frekuentoj mensat private

33.7% Gatuaj në dhomë

45.1% Të dyja bashkë

A mendoni se Q.S duhet të ofrojë shërbimin e ushqimit me mensa shtetërore?



4.7% Jo

15% Nuk e di

80.3% Po


Si i konsideroni çmimet në mensat private & FastFood-et përreth Q.S?



50.8% Të përbalueshme

49.2% Të papërbalueshme

Ngrohja në dhomën tuaj realizohet:




97.5% Nëpërmjet pajisjeve të sjella privatisht

2.6% Nëpërmjet sistemit të ngrohjes së konvikteve


Ndërkohë duke marrë parasysh rrezikshmërinë që sjellin rezistencat apo ngrorëset e sjella privatisht, 78.8% e studentëve të pyetur mohojnë praninë e sinjalistikës apo pajisjeve kundër zjarrit në ambientet e konviktëve dhe vetëm 21.2% e tyre shprehen se sinjalistika dhe këto pajisje ekzistojnë në konvikt.

Po në aspektin e sigurisë studentët u pyetën nëse u janë vjedhur sende në dhomën e tyre gjatë periudhës që kanë jetuar në konvikt. 10.4% e studentëve të pyetur u janë vjedhur sende në dhomën e konviktit, 7% e tyre nuk janë të sigurt nëse kjo ka ndodhur ndërsa 81% e studentëve mohojnë që të ketë ndodhur një vjedhje në dhomën e tyre.

A ka godina juaj
sinjalistikë
dhe pajisje
kundër zjarrit?



U janë vjedhur
sende në
dhomën tuaj?



2.3.4 Shërbimet e ofruara nga


Drejtoria e RSU Nr.1

Nisur edhe nga marrdhënia kontraktore e akomodimit që studentët vendosin me Drejtorinë e RSU nr.1 ata duhet të përfitojnë disa shërbime të cilat janë të drejtat e tyre në këtë kontratë. Studentët u pyetën për të shprehur opinionin e tyre nëse ishin të kënaqur për shërbimin që merrnin në raport me tarifën që paguanin. 54.4% e studentëve janë të pakënaqur dhe mendojnë se meritojnë shërbim më dinjitoz për tarifën që paguajnë, 4.5% e tyre janë disi të kënaqur dhe vetëm 4.2% e tyre janë shumë të kënaqur me shërbimin që u ofrohet.


Ndërkohë vetëm 2.6% e studentëve shprehen se interneti Ëi-Fi ofrohet në të gjithë territorin e Qytetit studentit siç ka deklaruar Bashkia Tiranë, 92% e studentëve pohojnë se shërbimi Ëi – Fi falas ofrohet vetëm në zona të caktuara ndërsa 6% e tyre shprehen se ky shërbim ofrohet vetëm brenda godinave të Q.S.

Studentët u pyetën në lidhje me kushtet dhe sallat e bibliotekës së Q.S ku 65.3% e studentëve i vlerësojnë si të papërshtatshme dhe vetëm 34.7% janë të kënaqur ose disi të kënaqur me këto ambiente studimi.


A jeni të kënaqur me shërbimin në raport me tarifën që paguani?



Wi-Fi e siguruar nga Qyteti Studenti aksesohet:



Si i vlerësoni sallat e studimi në Qytetin Studenti




2.3.5 Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje

Për shkak të numrit të lartë të studentëve dhe sistemit të organizimit në konvikt, përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe sistemi i ankesave mbi problematika merr një rëndësi të vecantë.


Sa i përket investimeve të qeverisë në kuadër të Paktit për Universitetin studentët kanë qëndrime të ndara. Më shumë se gjysma, 57.5% e studentëve shprehen se këto investime kanë qënë thjesht ndërhyrje vetëm në fasadë, 25.4% mendojnë se investimet nuk kanë sjellë përmirësime infrastrukturore dhe 16.6% e tyre shprehen se investimet në kuadër të Paktit për Universitetin kanë përmirësuar disi kushtet brenda godinave.

Përsa i përket raportimit të ankesave mbi problematika të ndryshme në konvikte, rreth 77% e studentëve i kujdestarit të godinës, 7% studentit përfaqësues të godinës dhe vetëm 4% drejtorit të RSU. 12% e studentëve nuk marrin mundimin të ankohen kur hasin problematika në konvikte.

85.5% e studentëve shprehen se nuk janë pyetur asnjëherë lidhur me cilësinë e shërbimeve të Qytetit Studenti, 10.9% shprehen se janë pyetur por opinionet e tyre nuk janë marrë parasysh, ndërsa vetëm 3.6% pohojnë se sugjerimet e tyre janë marrë parasysh nga vendimmarrësit në RSU nr. 1.



Nëse keni ndonjë ankesë ju i drejtoheni?



A është marrë ndonjëherë opinioni juaj lidhur me cilësinë e shërbimeve të Q.S?

